



Pranimi / Dorezimi / Punimja / Protokol / Received / Delivered		07-04-2021	1	viti / god / year
Organ / Bjesia / Organ / Jednica / Org / Unit	Nr. Prot / In Prot / Prot No	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity	
SKRIPSH/CK	1661/2021		113	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.98/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional/në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën e datës 24.02.2021 me numër A.nr.98/2021 të parashtruar nga ankuesi kundër vendimit të datës 20.02.2020 me nr.ref.50/2020, në çështjen juridike “*Kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.98/2021 e datës 24.02.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 24.02.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 812/2021 e regjistruar me numër A.nr.98/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore që ti aprovohet ankesa si e bazuar të anulohet Vendimin me nr.ref.50/2020 i datës 20.02.2020, duke kërkuar lënien në fuqi të Vendimit Nr. ref.323/2019 të datës 11.07.2019, me arsyetim se është në dijeni se ka parashtruar ankesë jashtë afatit por në mungesë të udhëzimit juridike, sipas njoftimit të datës 23.03.2020, pretendon se ka shkelje ligjore të udhëzimeve administrative, me rastin e lirit të tij nga detyra, sipas Ligjit për Shërbimin e Jashtëm, Ligjin Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik, Nëpunës të Misionit Diplomatik dhe Udhëzimin Administrativ 02/2012 për Plotësim dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ Nr.3/2009 për Procedurat e Emërimit të Kandidatëve për Nëpunësve të Ministrisë Diplomatike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullosës Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.03.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Ministri e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa Këshilli me datë 12.03.2021 ka pranuar përgjigjen në kërkesë me numër protokolli 1115/2021 se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 812/2021 të datës 24.02.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail i datës 02.05.2019; E-mail i datës 16.05.2019; E-mail i datës 31.05.2019; E-mail i datës 31.07.2019; Vendimi me Nr.323/2019 i datës 11.07.2019 të Zëvendës Kryeministrit të parë i Ministër i Punëve të Jashtme; Vendim nr. ref:50/2020 i datës 20.02.2020; Konkursi i datës 12.03.2019; Ankese e datës 26.02.2020 për Komisionin për ankesa dhe parashtresa-zyra ligjore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Kërkesë për Punësim i datës 28.03.2019; Certifikatë e datës 21.03.2019; Certifikatë mjekësore e datës 28.03.2019; Vërtetim i datës 28.03.2019; Resume; Diplomë e datës 15.10.2018 Kolegji Universum në Prishtinë; Diplome e datës 15.01.2016 Kolegji Viktori; Confirmim nga Universiteti i Varshavës i datës 17.08.2018; Transkriptim i datës 17.08.2018 Universiteti Varshavës; Certifikat e datës 25.02.2017 lëshuar nga Dortmund; Rekomandim lëshuar nga Kolegji Universum, janari 2019; Referencë e datës 25.05.2018; Referencë e datës 17.06.2013; Letër rekomandim e datës 17.06.2011; Letër rekomandim e datës 15.05.2007; pjesëmarrës i trajnimit Northrop Grumman i datës 15.05.2007; Letër rekomandim KFOR-MNB; Letër rekomandim e datës 05.01.2006; Letër rekomandim e datës 21.04.2005; Letër rekomandim e datës 26.11.2004; Letër rekomandim e datës 23.01.2004; Letër rekomandim e datës 03.12.1999; Mirënjohja e 2018; Certifikatë e datës 02.12.2006; Certifikatë e datës 01.12.2010; Certifikatë qershor 2011; Certifikatë e datës 18.11.2009; Certifikatë e datës 25-19.04.2004; Certifikatë e datës 10.10.2010; Certifikatë e datës 08.12.2014; Certifikatë e datës 12-14.04.2015; Përgjigje nr. ref.27/2020 e datës 23.03.2020, në ankesën e datës 26.02.2020; Përgjigje në ankesë e datës 12.03.2021; Njoftimi i datës 05.07.2019; Vendimi nr.144/2019 datës 08.03.2019; Vendimi nr. 313/2019 i datës 07.07.2019; Njoftim i datës 04.07.2019; Njoftim i datës 20.07.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pa lejuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se ankuesi me Vendimin Nr.ref.323/2019 të datës 11.07.2019, të zv.Kryeministrit të Parë/Ministrit të Punëve të Jashtme, është emëruar Konsull në Misionin Diplomatik të Republikës së Kosovës në Abu Dabi/Emiratet e Bashkuara Arabe, me mandat katër (4) vjeçar.

Ministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës me datë 20.02.2020 ka nxjerrë Vendim me Nr.Ref.50/2020 me të cilin ka shfuqizuar Vendimin me Nr. Ref. 323/2018 të datës 11.07.2019 me arsyetimin se ankuesi në kundërshtim me nenin 20 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm është emëruar Konsull në Misionin Diplomatik të Republikës së Kosovës në Abu Dabi/Emiratet e Bashkuara Arabe, duke obliguar ankuesin që të liroj detyrën në afat prej 15 ditësh nga data e këtij vendimi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në nenin 50 paragrafi 1 dhe nenin 81 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, i cili ka qenë i aplikueshëm deri me datë 09.07.2020, si dhe nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankese në KPMSHCK për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil. Ndërsa Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 127 përcakton se: *1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; 2. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.*

Poashtu kolegji bazuar në pretendimin e ankuesit se vendimi me Nr.ref.50/2020 i datës 20.02.2020 është lëshuar pa këshillë juridike konstaton se ankesa edhe sa i përket këtij pretendimi është ushtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar në nenin 127 paragrafi 3 i ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili shprehimisht parasheh'' **3. Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion,**



apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj”

Andaj, duke u nisur nga fakti se Vendimi Nr.Ref.50/2020 i Ministrisë të Punëve të Jashtme dhe Diasporës për shfuqizimin e vendimit me Nr.ref.323/2019 të datës 11.07.2019 është nxjerrë më datë 20/02/2020, ndërsa ushtrimi i ankesës është bërë me datë 24.02.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mbi këtë bazë kolegji konstaton se ankesa A.nr.98/2021 e datës 24.02.2021 është ushtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 të specifikuar më lartë të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.98/2021, datë 07.04.2021

Zyle Millaku GOJNOVCI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës,
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës,
- Arkivit të KPMSHCK-së.